REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 771119
Data/Datum. 21.11.19
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të raportit*	Nr. i lëndës:
Teuta Krasniqi	07.11.2019	21.11.2019	771/19,

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: **01.11.2019**, OE "**NNP WENDA**"- Vushtrri, ka parashtruar ankesë me nr: **771/19**, kundër njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku është rekomanduar për kontratë OE "Astraplan SH.P.K"- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Ndërtimi i çerdhes së re (projekt 3 vjeqar)"** me nr. të prokurimit: VU644-19-5755-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)–**Kuvendi Komunal-Vushtrris.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të **hapur**, lloji i kontratës: **Punë**, vlera e parashikuar e kontratës: 269.977,03€.

Ankesa nuk është e përsëritur.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE Ankesa 771/19

Dispozitat e shkelura sipas, grupit te OE "NNP WENDA"Vushtrri, te cilet kanë parashtruar ankesë me nr: 771/19, janë:

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i I.PP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 56 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së

pikat e ankesës:

Të nderuar ne me dt. 15.10.2019 jemi njoftuar mbi vendimin e AK-së, ku kanë rekomanduar për kontratë OE "AstraPlan" SH.P.K, ndërsa neve na kanë shpallur si tenderues të eliminuar me arsyet si në vijim: "Dëshmitë, siç është përshkruar në Seksionin:

II. Fleta e Të Dhënave të Tenderit (FTD) të Dosjes së Tenderit, Kërkesat mbi kapacitetin teknik dhe/ ose profesional, neni 9.1 lidhur me 9.2, pika I " Projekte të përfunduara të punëve të ngjashme në tre vitet e fundit nga data e publikimit të njoflimit për kontratë, min. 400.000,00 euro (€) Në rast Grupit të

Operatori ekonomik- lideri i grupit duhet të ketë kontrata të punës të realizuara gjatë tre viteve të fundit deri me datën e publikimit të Njoftimit për Kontratë jo me pak se 60% të vlerës së saktësuar si më lartë" tregojnë arsyeshëm se ju nuk i përmbushni kërkesart minimale të kapacitetit teknik dhe / ose financiar të saktësuara në dosjen e lenderit dhe në Njoftimin e Kontratës sikurse u saktësua më lartë, që nënkupton se : Ju nuk i përmbusheni kërkesën e AK-së që, gjatë tre viteve të fundit deri me datën e publikimit të Njoftimit për Kontratë, të keni përfunduar projekte të ngjashme në vlerën min. 400.000, 00€.
Nga vlerësimi dhe ekzaminimi i Listës së projekteve të ngjaishme, me titullin e aktivitetit të prokurimit në të cilin keni tenderuar, rezulton se ju në tre vitet e fundit keni realizuar-përfunduar projekte të ngjashme deri në vlerën 170,405174€ që nënkupton se nuk përmbushni kërkesën e AK-së që OE në tre vitet e fundit të deri me datën e publikimit të Njoftimit për Kontratë të ketë realizuar punë të ngjashme në vlerën min. 400. 000€.

Mungesa të dëshmive të kërkuara si në Njoflimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit paraqet shmangie nga kërkesat saktësuara si në nenin 9.1 lidhur me 9.2 -pika I të Seksionit II të fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), Kërkesat mbi mundësit Teknike dhe/ose Profesionale.

Kjo ka ndikuar drejtpërdrejtë në paunundësi të plotësimit, prej juve, të kërkesave të saktësuara, mos dëshmimin e aftësisë suaj për ti përmbushur Kërkesat e kapacitetit teknik dhe / ose profesional, dhe për rrjedhojë edhe në garantuar dhe siguruar AK për përfundimin e sigurt, në kohë dhe në mënyrë cilësore të punëve dhe / ose shërbimeve për të cilat keni aplikuar - tenderuar, në veçanti lidhur me kapacitetin teknik profesionul dhe besueshmërinë e kryërjes së punëve të njëjta si në titull të aktivitetit të prokurimit.
Në pajtim të plotë me dispozitat e LPP-së dhe Rregullave të Prokurimit Publik, Autoriteti Kontraktues nuk mundë të ndryshoj asnjë aspekt të një tenderi ndërsa, Tenderuesi është përgjegjës për të siguruar saktësinë e tenderëve të tyre, bazuar në kërkesat e parashtruara në dokumentin Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT) .

Në këtë mënyrë ju si Operator Ekonomik nuk keni respektuar këto kërkesa dhe për pasojë keni bërë devijim thelbësorë nga kërkesat e percaktuara dhe specifikimet e detyrueshme gjegjësishi keni bërë devijim qenësor-thelbësor nga kërkesat e tenderit, gjë që ka bërë që vlerësimi për rregullshmërinë e dëshmive të dorëzuara lidhur me specifikimin e kualifikimeve shkollore dhe profesionale të personelit tuaj udhëheqës të jetë mos jetë i plotë, i rregullt dhe i pranueshëm. "

Të nderuar ju sqarojmë se autoriteti kontraktues ka rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik "AstraPlan" SH.P.K i cili ka ofertuar me çmim më të lartë se ne, ndërsa neve na ka eliminuar me arsyet e lartcekura të cilat janë të pa bazuam dhe të paqëndrueshme.

Ju sqarojmë se ne e plotësojmë kërkesen në lidhje me kapacitetin teknik dhe profesional të parashikuar në nenin 9 1&9.2 të FDT-së sa i përket kontratave të përfunduara në tri vitet e fundit, ndërsa në dosje të tenderit dhe tek njoftimi për kontratë askund nuk është kërkuar që OE të prezantojnë dëshmi për kontrata në ndërtim të lartë apo të ulët.
Ne nenin 9.1&9.2 të FDT-së është kërkuar: "Projekte të perfunduara të punëve të ngjashme në tre vitet e fundit, nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, minimum në vlerë 400,000.00 Euro, Nëse OE tenderojnë në marrëveshje apo konzorcium, atëherë lideri i grupit duhet t'i ketë 60% të vlerës së kërkuar"

Pra kërkesë e AK-së ka qenë projekte te punëve të ngjashme, e të cilën kërkesë ne e kemi plotësuar.

Ne kemi ofruar listën e kontratave ku figuron se shuma totale e punëve të kryera është 2,169.436.51 €.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe kërkesat që i cekëm më lartë kuptohet qartë se AK-ja ka vepruar në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së sepse na ka eliminuar për një kërkesë që nuk është parashikuar në dosje të tenderit dhe tek njoftimi për kontratë, ndërsa neni 56.3 qartë e parasheh që "Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kuftzuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Autoriteti kontraktues na ka diskriminuar neve me vendimin e tyre edhe pse ne i plotësojmë të gjitha kërkesat e FDT-së dhe njoftimit për kontratë, na ka refuzuar tenderin tonë me arsyet e lartcekura.

Ne ju sqarojmë se e kemi plotësuar kërkesën e AK-së tek kërkesat teknike dhe profesionale 9. I dhe 9.2 të FDT-së, pasi kemi dorëzuar listën të nënshkruar dhe të vulosur se bashku me referenca dhe raporte të pranimeve teknike, dhe meqë AK-ja nuk ka kërkuar referenca të ndërtimit të lartë apo të ulët por e ka cekur referenca të ngiashme, andaj projektct tona të përfunduara brenda 3 viteve të fundit nga njoftimi për kontratë e plotësojnë kërkesën e AK-së, sepse ne paramasë dhe parallogarr të këtij aktiviteti të prokurimit dhe të gjitha punë të perfunduara në listën e kontratave të cilën e kemi dorëzuar, në secilën kontrate kemi njërën nga këto punë.
Po ashlu një fakt që vlen të përmendel është se edhe pse AK-ja pretendon se ne nuk i kemi plotësuar kërkesat e lartcekura, është për tu çuditur fakti se ne si OE i kemi 90% të kontratave të projekteve te prezantuar në këtë listë, janë punë që kemi kryer me autoritetin kontraktues Komuna e Vushtrrisë dhe këta e njohin dhe e din kapacitetin tonë dhejanë të vetëdijshëm se ne mund të realizojmë këtë projekt pa asnjë vështirës dhe kemi kapacitetin teknik dhe profesional.
Pra ne edhe pse e plotësojmë kërkesën e lartpërmendur të AK-së, duke i plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftiniit për kontratë, nuk jemi shpall fitues por jemi eliminuar edhe pse jemi ofertues me çmimin më të lirë se OE i rekomanduar për kontratë.
AK-ja me këtë vendim ka renë në kundërshtim me kërkesën e tyre që kontrata duhet ti jepet OE të përgjegjshëm me çmim më të ulet, ashtu siç parashihet edhe në nenin 6(të I.PP-së ku shkruan sc: "Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operaiorit ekonomik që ka dorëzuar ose tenderin e pergjegjshëm me çmimin me të ulët.
AK-ja nëse ka pasur dilema për ndonjë kontratë ka mundur të kërkojë sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së.
Në vendimin e dt:25.10.2019 për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, autoriteti kontrakluës ka thënë se ne duhet të sqarojmë edhe faktin se kemi ende komrata të pa përfunduara si ai:
Ndërtimi i punëtorisë dhe kabineteve në shkollën e mesme teknike porok. 3. 4, 5. 6. Nr. 644-1 "8-172-521", projekt ky i cili është dashur të përfundoi qysh me di. 30 Gusht 2019 dhe ende sot e kësaj dite nuk është përfunduar pa ndonjë arsye të justifikueshme, duke shkaktuar dëme A.K. dhe vonesa në përdorimin e objektii konlraktuar, apo edhe Kontrata respektivisht projekti :Lot.l-Renovimi i(tri) objekteve shkollore, prok. Nr.644-19-032-521, i cili sipas kontratës është dashur të përfundohet brenda 60 ditëvce ndërsa ende deri me sot punë nuk janë përfunduar duke i shkaktuar po ashtu dëme AK-së.
Në lidhje me këtë pretendim të AK-së ju sqarojmë se kjo nuk ka qenë arsve e eliminimit dhe nuk mund të jetë arsye e eliminimit e bazuar në ligj sepse ne jemi duke i kryer punimet në çdo projekt ashtu siç parashihet, mirëpo edhe po të ekzistonte ky fakt atëherë
AK-ja nuk mund të eliminojë asnjë OE. i cili nuk i përmbahet kontratave të shkuara pa ndonjë vendim të formë së prerë nga gjykata kompete nte. Këtë e parasheh neni 65 paragrafi 3.2 dhe 3.5 i LPP-së.
Ne lidhje me këtë çështje (neni 65 par.3.5 të LPP-së ekziston edhe një interpretim i KRPP- së ku në pyetjen

nr. 62 shkruan si në vijim: "62. Për veç "Gjykatës Kompetente", në bazë të paragrafit 3.5 të nenit 65 të LPP-ës cilat organizata apo agjenei administrative në Republikën e Kosovës mund ta konstatojnë sjelljen jo profesionale të një Operatori Ekonomik gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij?
Konform nenit 87, paragrafit 2, nën-paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, sa i përket çështjes së lartë përmendur, KRPP ofron interpretim ligjor si në vijim:
Neni 65.3.5, sa i përket përjashtimit nga pjesëmarrja të një Opcratori Ekonomik në një aktivitet të prokurimit përcakton si në vijim:
"3. Operatori ekonomik nuk ka të drejtë të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operalori i tillë ekonomik, ose ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluara:

- 3.5. është konstatuar nga një gjykatë kompetente, agjenci administrative ose organizatë për zbatimin e standardeve të sjelljes profesionale, se është sjelle ne mënyrë joprofesionale; "

Neni i referohet sjelljes joprofesionale, të cilat duhet të jenë të destinuara si sjelljet e një operatori ekonomik të kryera gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij profesionale.
Në mënyrë që të jetë në përputhje me fusheveprimin e LPP-se, e në veçanti me paragrafin e lartë cituar sjellja duhet të konstatohet nga një gjykate, agjenei administrative ose organizatë për zbatimin e standardeve të sjelljes profesionale.
Në mungesë të një agjencie administrative ose organizate për zbatimin e standardcve të sjelljes prolësionale në Kosovë, tani për tani, KRPP, konsidcron se sjellja jo profesionale e një Operatori Ekonomik mund të konstatohet vetëm nga gjykata kompetente.
Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë, konstatojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tendcrëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së sepse ne jcmi ofertues i përgjegjshcm duke i plotësuar të gjitha kërkesat e FDT- së dhe të njoftimit për kontratc duke ofruar deshmi sipas nenit 64 tc LPI'-së pcrkitazi me nenin 69 të I.PP-së,
Po ashtu AK-ja nuk c ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së sepse ne jemi di Triminuar si OE i përgjcgjshëm dhe me çmim më të ulët, ndërsa është favorizuar OE i rekomanduar për kontratë.
Gjithashtu autoriteti konlraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë menyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe te gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.
Të nderuar, ju sqarojmë se autoritetet kontraktuese janë të obliguar që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike. njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lendën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktei që u përmendën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr:

VENDIM

APROVOIIET, si e bazuar ankcsa e OE **NNP " WENDA"**

ANULOHET, njoftimi për dhënic të kontralës dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM.**
DETYROHF.T, autoriteti kontraktues që të vazhdojë me procedurë të rivlerësimit konform dispozitave të LPP-së, kërkesave të FD'l' dhe të njoftimit për kontratë.

Nëse nuk merren parasvsh laktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institueionet tjera kompetente.

5. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën sesi shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohe/t 'i shkaktojë dëme materialeparash/ruesil lë ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, në vlerë prej 5,000.00 euro.

KRITERET PËR VLERËSIM

III.2)KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional

1. Projekte të përfunduara të punëve të ngjashme në tre vitet e fundit, nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, minimum në vlerë 400,000.00 Euro. Nëse OE tenderojnë në marrëveshje apo konsorcium, atëherë lideri i grupit duhet t'i ketë 60% të vlerës së kërkuar.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1.Listën me të cilën specifikohen të gjitha projektet e punëve dhe aktivitetet ndërtimore të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, të përcjella me certifikata për kryerje dhe ose përfundim të kënaqshëm; certifikatat ose referencat për kontraat e realizuara ku përcaktojnë vlerën, datën dhe vendndodhjen e projekteve të punëve dhe ose aktiviteteve ndërtimore dhe specifikojnë nëse janë kryer dhe ose përmbushur në përputhje me rregullat tregtare dhe janë përfunduar siç duhet;

Kriteret e Dhënies

Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët.

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

1. **Euro Project"sh.p.k** - i plotëson
   kërkesat e Autoritetit Kontraktues. Dhe të njëjtin e rekomandojn që të shpërblehet me kontratë me

arsytimin se OE,është Oferta me e pergjegjëshme me çmimin me te ultë.

2. **Muratori "sh.p.k-Euro Project sh.p.k** -i plotëson kërkesat e Autoritetit Kontraktue,mirpo nuk është Oferta e pergjegjëshme me çmimin me te ultë.
3. **Kompania Prishtina" sh.p.k-** Në bazë të dokumenteve të kërkuara në njoftimin për kontratë dhe në DT ,Ju i plotsini te gjitha kushtet e parapara ne njoftim per kontrat dhe ne dosjen e tenderit si nga aspekti tekik ashtu edhe financiar, mir po jeni shpallë i pasukseseshëm.
4. **NNP"Wenda"**Në njoftim për kontrat dhe ne FDT ishte kërkese kapacitetit teknik dhe profesional: Projekte të përfunduara të punëve të ngjashme në tre vitet e fundit, nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, minimum në vlerë 400,000.00 Euro. Nëse OE tenderojnë në marrëveshje apo konsorcium, atëherë lideri i grupit duhet t'i ketë 60% të vlerës së kërkuar

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1.Listën me të cilën specifikohen të gjitha projektet e punëve dhe aktivitetet ndërtimore të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, të përcjella me certifikata për kryerje dhe ose përfundim të kënaqshëm; certifikatat ose referencat për kontraat e realizuara ku përcaktojnë vlerën, datën dhe vendndodhjen e projekteve të punëve dhe ose aktiviteteve ndërtimore dhe specifikojnë nëse janë kryer dhe ose përmbushur në përputhje me rregullat tregtare dhe janë përfunduar siç duhet.

Autoriteti kontraktues në bazë te dispozitave te LPP-së dhe Rregullave te prokurimit publik të Kosovës ka vendosur që oferten e juaj ta refuzoj, prandaj edhe jeni shpallet si tenderues i eliminuar.

5.**"Astraplan"sh.p.k** - si OE i përgjegjëshem me çmimin me të lirë.

Ndersa me daten 15.10.2019 Udhëheqsi i Departamentit të Prokurimit i AK- ka marr vendim që në bazë të raportit të vlersimit të publikoj njoftimin mbi vendimin e AK dhe të shpall fitues OE "**Astraplan"sh.p.k "** si OE i përgjegjëshem me çmimin me të lirë.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

OE ankues është palë me interes,sepse i njejti është ofertues

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES-" NNP"Wenda" -Ankesa 771/19

Duke u mbeshtetur në ekzaminimin e dosjes se tenderit dhe shqyrtimit të procesit të vlerësimit të tenderit, konstatojmë me sa vijon:

Përgjigjje në Pretendimi nr.1

OE ankues**"NNP.Wenda"**-Vushtrri pretendon se K.K . Vushtrris nuk ka respektuar nenin 1 të LPP-së,

Eksperja thekson se qellim i ketij neni është te sigurojn menyrë ma efikase ,më transparente dhe më të drejtë të shfrytzimit të fondeve publike ,duke përcaktuar kushtet rregullat qe do te zbatohen , procedurat qe do te ndiqen ,te drejtat qe do te respektohen dhe detyrimit qe do te permbushen,

OE.ankues pretendon duke permend vetëm pjesën e nenit 1 për qllimin e nenit dhe mënyren e shfrytzimit të fondeve dhe burimeve publike pa i permendur kushtet rregullat qe do te zbatohen , procedurat qe do te ndiqen ,te drejtat qe do te respektohen dhe detyrimit qe do te permbushen.

Andaj edhe pretendimi i OE.ankues është i pa bazuar,
Sepse nuk mundë të shpallet fituesit një OE . pa u siguruar se i ka plotsuar te gjitha kriteret e parapara ne NJ. dhe DT.sepse nuk do të ishte në harmoni me nenin 1 te këtij ligji,

Andaj,
Ekspertja konstaton se ky pretendim është i pa bazuarë .

Përgjigje në Pretendimi nr.2

OE ankues**"NNP.Wenda"**-Vushtrri pretendon se KK. - Vushtrris nuk ka respektuar nenin 6 të LPP-së, sipas OE.ankues .
Eksperja thekson se qellim i ketij neni është te siguroj qe fondet publike dhe burimet publike të perdoren në menyrë me ekonomike ,duke e marr ne konsiderat qellimin dhe lenden e prokurimit ,
Andaj trajtimi i OE. akues i eleminuar është në harmoni me nenin 6 të LPP-së . (arsyet e eleminimit do sqarohen me posht konkretisht ne pretendimet 4 . dhe 5 lidhur me nenet 56 dhe 59 te LPP-Së.)

Eksperja konstaton se ky pretendim është i pa bazuar .

Përgjigje në Pretendimi nr.3

OE ankues**"NNP.Wenda"**-Vushtrri pretendon se K.K .-Vushtrris nuk ka respektuar nenin 7 të LPP-së, sipas OE.ankues .
Eksperja thekson se qellim i ketij neni është trajtimi i barabartë dhe jo diskriminues i të gjithë ofertuesve dhe trajtimi si OE. të eleminuar, Operatorin ekonomik ankues që nuk i ka plotësuar kriteret e parapara me NJ.K. dhe DT.është në harmoni me nenin 7 të LPP-së .

Eksperja konstaton se ky pretendim është i pa bazuar .

Përgjigje në Pretendimi nr.4

OE ankues**"NNP.Wenda"**-Vushtrri pretendon se K.K .-Vushtrris nuk ka respektuar nenin 56 të LPP-së, sipas OE.ankues .

Eksperja thekson se qellim i ketij neni është të respektohen kriteret e parapara me Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit dhe vlerësimi të bëhet konfoorm ketij neni.

OE ankues,pretendon se AK-së ka vepruar në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së sepse na ka eliminuar për një kërkesë që nuk është parashikuar në dosje të tenderit dhe tek njoftimi për kontratë, ndërsa neni 56.3 qartë e parasheh që "Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kuftzuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, sipas OE ankues .

Eksperja për të sqaruar fillimisht paraqet kriterin e paraparë me NJ.K. dhe D. T. i cili është pikë pretenduese :

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional

1. Projekte të përfunduara të punëve të ngjashme në tre vitet e fundit, nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, minimum në ***vlerë 400,000.00 Euro.*** *Nëse OE tenderojnë në marrëveshje apo konsorcium, atëherë lideri i grupit duhet t'i ketë 60% të vlerës së kërkuar.*

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1.Listën me të cilën specifikohen të gjitha projektet e punëve dhe aktivitetet ***ndërtimore*** *të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, të përcjella me certifikata për kryerje dhe ose përfundim të kënaqshëm; certifikatat ose referencat për kontraat e realizuara ku përcaktojnë vlerën, datën dhe vendndodhjen e projekteve të punëve dhe ose aktiviteteve ndërtimore dhe specifikojnë nëse janë kryer dhe ose përmbushur në përputhje me rregullat tregtare dhe janë përfunduar siç duhet;*

OE ankues pretendon se AK-së nuk ka kerkuar referenca të ndertimit të lart apo të ulët por ka cekur referenca të ngjaishme andaj projektet tona të perfunduara brenda 3 viteve të fundit nga njoftimi për kontratë e plotësojn kerkesen e AK-së

Ekspertja sqaron se pretendimi i OE. nuk është i sakt lidhur me kriterin e paraparë me NJ.K. dhe D. T. sepse OE . ankues nuk e ka permendur fjalin kryesore që e përcakton ngjajshmërin e kontratave e që është cekur te deshmia e kerkuar dokumentare **„ aktivitete ndërtimore ''** është esenciale kjo fjali sepse bazuarë në ketë fjali e kemi të qart se cilat kontrata janë të ngjaishme .

(1.Listën me të cilën specifikohen të gjitha projektet e punëve dhe **aktivitetet ndërtimore** të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare)

Ekspertja sqaron se OE. ankues ka dorëzuar listën e kontratave në platformën e e-prokurimit të nënshkruar dhe të vulosure , mirëpo në atë listë ma tepër ka kontrata për Rrugë, Kanalizime ,Rrugë me kocka pastrim lumejsh,i njejti ka edhe disa kontrata për punë ndërtimore dhe të ngjajshme mirëpo të njejtat nuk e arrijn minimumin e kriterit të paraparë me NJ.K.dhe me D.T.

(Gjat egzaminimit- kalkulimeve të vlerave të cilat gjinden në referenca ekspertja ka vërejtur që disa referenca të njëjta me numra të protokollit të njejtë janë skenuarë dhe janë ngarkuar në platformën e e-prokurimit nga dy here nga OE.ankues ,ketë e potencoi për shkak të korrektësisë dhe me qellim që palët të informohen se një veprim i tillë është i pa pranueshëm sepse njëra referencë shihet mirë kurse referenca tjetër shihet me shumë veshtërësi sepse skenimi është bërë në atë mënyrë dhe në këto raste Autoritetet kontraktuese mund të bien në lajthim pa dashje e kjo nuk ka ndodhur në rastin konkret.)

Andaj,
Ekspertja Konstaton se pretendimi është i pa bazuarë .

Përgjigje në Pretendimi nr.5

OE ankues**"NNP.Wenda"**-Vushtrri pretendon se K.K .-Vushtrris nuk ka respektuar nenin 59 të LPP-së, sipas OE.ankues .

Eksperja thekson se qellim i ketij neni është Ekzaminimi vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve ,fillimisht autoriteti kontraktues ka themeluar komision të vlerësimit i cili OE. ankues e ka trajtuar si OE. të pa përgjegjëshëm dhe trajtimi si OE i eleminuar Operatorin ekonomik ankues është në harmoni me nenin 59 të LPP-së .
Sa i perket pretendimit se OE. ankues ,lidhur mundesin e heqjes së dilemave për ndonjë kontratë përmes kerkesës për sqarime bazuar në nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së i njejti pretendim nuk qendron sepse autoriteti kontraktues nuk ka pasur diqka të paqart rreth kontratave sepse janë referencat e bashkangjitura që deshmojn për aktivitetet e OE. ankues ,e që shumica e atyre referencave ishin të lëshuara nga vet AK-së

Sa i perket pretendimit se AK-së e ka eleminuar padrejetësisht OE.ankues nuk qendron,

Andaj,
Eksperja konstaton se ky pretendim është i pa bazuar .

Përgjigje në Pretendimi nr.6

OE ankues**"NNP.Wenda"**-Vushtrri pretendon se K.K .-Vushtrris nuk ka respektuar nenin 60 të LPP-së, sipas OE.ankues .
Eksperja thekson se qellim i ketij neni është të respektohen kriteret për dhënjen e kontratës dhe kriter për dhenjen e kontratës ka qenë :

Tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

Sa i perket pretendimit se OE.ankues i ka plotsuar kriteret e parapara me NJ.K. dhe D.T. nuk qendron dhe është i pa bazuarë,

Andaj,
Eksperja konstaton ky pretendim është i pa bazuar .

Përgjigje në Pretendimi nr.7 dhe Përgjigje në Pretendimin nr.8

OE ankues**"NNP.Wenda"**-Vushtrri pretendon se K.K .-Vushtrris nuk ka respektuar nenin 69 dhe 72 të LPP-së, sipas OE.ankues .
Ekspertja sqaron se qellim i neni 69 është Aftesia teknike dhe profesionale e Ofertuesve dhe mundesia e sqarimeve përmes kerkesave nga AK-së përmes nenit 72 të ketij ligji
OE.sipërfaqsisht e permendë nenin 69 lidhur me pretendimin se nuk është zbatuar neni 69 i ketij ligji nuk qendron,
Pretendimi i OE.ankues nuk qendron sepse OE ankues nuk i ka plotësuar kriteret e parapara me NJ. K. dhe DT. .(siq është sqaruar në përgjigjëjen nr.4 dhe nr.5)

Andaj,
Eksperja konstaton ky pretendim është i pa bazuar .

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, ekspertja shqyrtuese i propozon panelit shqyrtues që ankesën e Operatorit ekonomik ta HUDHË POSHT SI TË PA BAZUAR, (për arsyet që u cekën tek përgjigjëjet në secilin pretendim) dhe i rekomandon panelit shqyrtues që vendimi i Autoritetit Kontraktues të mbetet në fuqi.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **Kuvendi Komunal-Vushtrri** .
- Panelit Shqyrtues – **OSHP.**
- OE ankues – **NNP.Wenda"**-Vushtrri